

FTESË

Të nderuar kolegë dhe miq,

Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, në përmbyllje të programit “**E drejta për të vërtetën - fakt apo fiction**”, organizon eventin publik për prezantimin e gjetjeve të raportimit të monitorimit mbi kontekstin ligjor dhe institucional ***në ndihmë të familjeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.***

Përmes prezantimit dhe diskutimit të këtij raporti me aktorë kryesorë të shtetit, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, shoqërinë civile dhe studiues, synohet të adresohet nevoja e ballafaqimit të së shkuarës për adresimin e mungesës ligjore për ofrimin e zgjidhjes së kësaj çështjeje të rëndësishme për Shqipërinë dhe sfidat në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Ky event organizohet:



6 KORRIK ⌚ **10.00 – 12.30 h**



***pranë ambjenteve të Universtitetit WISDOM
(rruga Medar Shtylla, Komuna e Parisit)***

Ky event publik organizohet në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” të zbatuar nga ICMP-AIDSSH, me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe Ambasadës Zvicerane.

Pjesëmarrja Juaj në këtë event është kontribut i vyer për identifikimin e hapave drejt zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Ju mirëpresim !

@ Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim

ians_org@yahoo.com

Office: +45628849

Mobile: +682079385

PROGRAMI

9.30 *Regjistrimi i pjesëmarrësve -pushim kafe*
Shpërndarja e studimit për pjesëmarrësit

10.0 – 10.30 HAPJA - Paneli përshëndetës i Eventit

- Zj. Blerta Balili, drejtore bordi – IANS
- Z. Luigj Ndou, drejtues për marrëdhëniet me Qeverinë, ICMP
- Zj. Ardita Repishti, AIDSSH

Moderimi: *Prof. As. Dr. Ervin Karamuço, profesor i së Drejtës Penale dhe Kriminologji*

10.30- 12.30 Prezantimi i Raportit të Monitorimit mbi statusin e personave të pagjetur gjatë diktaturës komuniste

Paneli i Ekspertëve: Dr. Anita Pilika, eksperte dhe zj. Erinda Bllaca, IANS

Diskutime - me kontributin e pjesëmarrësve

12.30 Mbyllja, koktej

Me pjesëmarrjen e:

- ÷ *Institucionit të Avokatit të Popullit*
- ÷ *Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi*
- ÷ *Strukturave të drejtësisë*
- ÷ *Strukturave ligjzbatuese*
- ÷ *Strukturave të pushtetit vendor*
- ÷ *Përfaqësues të organizatave të ish-të përndjekurve politikë*
- ÷ *Përfaqësues të shoqërisë civile dhe media*
- ÷ *Akademikë, si dhe*

- ÷ ***Çdokush që mendon se mund të kontribuojë në zgjidhje !!!***

Rreth Programit

E drejta për të vërtetën është koncept ligjor që në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar ka të bëjë me detyrimin e shtetit për të siguruar informacion për viktimat ose për familjet e tyre apo edhe shoqërinë në tërësi, në lidhje me rrethanat që shkelin të drejtat e njeriut.

Një e drejtë e tillë duhet të përmbushet dhe shkon përtej përcaktimit të fajësisë apo pafajësisë së individëve të veçantë. E drejta për të vërtetën nxitet nga qëllime të tilla të larta si kontributi në "rivendosjen dhe ruajtjen e paqes" dhe "procesi i pajtimit kombëtar", të tilla si lufta ndaj pandëshkueshmërisë, parandalimi i shkeljeve në të ardhmen, përmbushja e kërkesave të viktimave, nevojat dhe përkrahja e të drejtave të tyre, largimi i figurave me rrezikshmëri nga skena politike, rivendosja e sundimit të ligjit dhe riafirmimi i parimit të ligjshmërisë.

Ky event publik organizohet në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste" të zbatuar nga ICMP-AIDSSH, me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe Ambasadës Zvicerane.

Projekti "E drejta për të vërtetën, fakt apo fiction" mundësoi rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të shoqërisë civile në proceset tranzitore dhe të pajtimit për familjet e personave të zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri. Ai fuqizon qasjen monitoruese të të drejtave të njeriut nga aktorët e shoqërisë civile përballë informacionit shtetëror dhe siguron mundësi për rrjetëzim dhe veprime të përbashkëta për kauzën.

Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social falënderon në mënyrë të veçantë çdo aktor, që përmes zërit, forcës dhe kontributit personal jetëzoi këtë program në mbrojtje dhe në nderim të çdo personi që fali jetën për demokracinë në Shqipëri.

#IANS#ICMP#AIDSSH#EUD#SwissEmb